

V E N D I M
Nr.244, datë 20.3.1998

**PËR KËSHILLIN E POLITIKËS SHKENCORE DHE TË ZHVILLIMIT
TEKNOLOGJIK**

Në zbatim të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik” dhe të ligjit nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e Këshillit të politikës shkencore dhe zhvillimit teknologjik pranë Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i politikës shkencore dhe i zhvillimit teknologjik kryen këto detyra kryesore:

- Përcakton dhe drejton përparësitë e politikës shkencore e të zhvillimit teknologjik, të përshtatshëm për zhvillimin ekonomiko-shoqëror dhe për programet e kërkimit që lidhen me të.
- Jep mendimin për projektligjet dhe projektvendimet për veprimtarinë shkencore e teknologjike, që i paraqiten për miratim Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave.
- Bën vlerësimin periodik të arritjeve të politikës shkencore dhe të zhvillimit teknologjik.
- Përcakton detyrat për organet shtetërore për zhvillimin dhe përdorimin e potencialeve shkencore.

- Krijon komisione dhe grupe pune të përhershme për probleme të caktuara.

3. Këshilli i politikës shkencore dhe i zhvillimit teknologjik kryesohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave dhe ka në përbërjen e tij Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ministrin e Financave, Ministrin e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministrin e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrin e Shtetit pranë Kryeministrit, Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrin e Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe 7 shkencëtarë të shquar, që caktohen nga Kryetari i Këshillit të Politikës Shkencore dhe Zhvillimit Teknologjik.

4. Pranë Këshillit të politikave për zhvillimin teknologjik funksionon sekretaria e këtij Këshilli, e cila kryen funksione organizative dhe përbëhet nga punonjës të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilët caktohen në këtë funksion nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrë udhëzimet përkatëse në bazë dhe për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.424, datë 6.8.1993 dhe nr.158, datë 7.4.1995 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano